



Republika e Kosovës  
Republik of Kosova  
Republika Kosovo



Komuna e Vitisë  
Municipality of Vitina  
Opstina Vitina

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-068, për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës neni 5 pika d, neni 35 pika 1.të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr.04/L-032, dhe të Udhëzimit administrativ të MASHT-it, nr.08/14 të dt.25.02.2014,për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes drejtorëve dhe të zv.drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese, Drejtoria e Arsimit shpall:

## **KONKURS PUBLIK**

### **Për plotësimin e vendit të lirë të punës për drejtor shkolle**

-Drejtor në Shm të lartë Gjymnazë-Teknikë „Kongresi i Manastirit” në Pozhoran.

#### **Kushtet :që duhet ti plotësojnë kandidatët që konkurojnë në këtë konkurs:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit univerzitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore.
- Të kenë licencë të rregulltë të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedur të licencimit.
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëqetje, administrim ose menagjim.
- Të kenë më së paku 3-vjet përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit.

#### **Të posedojnë këto dokumente:**

- .Çertifikatën e lindjes
- .Diplomën e fakultetit të kryer për nivelinë përkatës
- .Dëshminë për përvojen e punës
- Portfolion profesionale (shih shtojcën G).
- Letër reference nga një institucion publik – kredibil (ministra e arsimit shkencës dhe teknologjisë,DKA, këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë).
- Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake.
- Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues për të cilin ka konkuruar (së paku 10 faqe tekst me hapsirë 1.5, fonti i shkronjave me 12, arial) sipas udhëzimit të MASHT.
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion shëndetsor publik me të cilën dëshmohet gjendja e tij / saj shëndetësore.
- Dëshminë se nuk është nën hetime.
- Kopjen e letërnjoftimit.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegje private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurojnë për këto pozita duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin

administrative nr.8/2010 të datës 22.06.2010, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të rrefuzoj ç'do aplikacion të kandidatëve të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet e konkursit.

Kandidatët e interesuar aplikacionet i marrin dhe i dorëzojnë në Drejtorin Komunale të arsimit në Viti.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik. Dokumentet e pa kompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

**Më: 05.05.2015**  
**Viti**

**Drejtoria e Arsimit KK-Viti**